



REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

---

**K.Dh.Sh II.nr.1508/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen përmbartimore të kreditorit “Union” Sh.P.K, me numër unik identifikues 810356718 dhe seli në Mitrovicë, përfaqësuar sipas autorizimit nga Korab Rexhepi, avokat nga Prishtina, kundër debitorëve: 1.“New Group” L.L.C., me numër unik identifikues 810011669 dhe seli në Prishtinë, Zona Industriale, dhe 2.Kompania e Sigurimeve “Prisig” Sh.A. me numër identifikues 810842832 dhe me seli në Prishtinë, rr. “Eduard Lir”, objekti 2, lagja Arbëri, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e të autorizuarit të kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.702/22 të datës 20.09.2023, me datë 17.04.2024, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pathemeltë ankesa e kreditorit “Union” Sh.P.K., me seli në Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr. 702/22 të datës 20.09.2023, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë KPPP.nr. 702/22 të datës 20.09.2023, në pikën I të dispozitivit e ka pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Kompania e Sigurimeve “Prisig” Sh.A.,me seli në Prishtinë të ushtruar kundër Urdhrit për Përmbartim P.nr.

253/21, të dt. 27.07.2021, të Përmbaresit Privat Mubarak S. Shumolli dhe i njëjti Urdhër për përmbarrim në pikën II të dispozitivit është anuluar.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë i autorizuari i kreditorit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbarrimore, për shkak të vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhoma e Shkallës së Parë - Departamenti Ekonomik, KPPP.nr. 702/22 të datës 20.09.2023, apo të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Debitori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të autorizuarit të kreditorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “Union” Sh.P.K., me datën 27.07.2021, ka paraqitur propozimin për përmbarrim mbi bazën e dokumentit të besueshëm, dokumentit të besueshëm – Faturës nr. 848/20, të datës 23.10.2020, në vlerë prej EUR 33,890.00, faturës nr. 878/20 të datës 28.10.2020 në vlerë prej EUR 7,150.00, si dhe Deklaratës Garantuese me numër 0700100114783, të datës 19.10.2020, e ka lejuar urdhrin P.nr. 253/21, të datës 27.07.2021, me të cilën janë urdhëruar debitorët New Group L.L.C., dhe KS “Prisig” Sh.a, për arkëtimin në mënyrë solidare me dhunë të obligimit në emër të borxhit në shumë prej EUR 41,040.00, me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data e arritshmërisë për pagesë të faturës e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbarrim në lartësi prej EUR 312.00.

Debitori, Kompania e Sigurimeve “Prisig” Sh.a., brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbarrimor, urdhrin mbi lejimin e përmbarrimit, me arsyetim se dokumenti mbi bazën së cilit është iniciuar urdhri nuk përbën dokument përmbarrimor, përkatësisht

deklarata e garancisë nuk ka tipare të dokumentit përmbarues dhe as dokumentit të besueshëm. Ka shtuar se dokumentet nuk janë dorëzuar në origjinale ashtu siç përcaktohet me neni 38 të LPP-së, andaj gjykatës i ka propozuar që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ashtu që urdhri përmbarimor të shfuqizohet. Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se prapësimi i debitorit nuk është i bazuar në neni 71 të LPP-së, dhe se debitori ka dështuar ta bëjë të besueshëm pretendimin e tij, ngase nuk ka paraqitur asnjë provë në këtë drejtim. Po ashtu ka shtuar se faturat e paraqitura si dokument të besueshme i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore që të konsiderohen dokumente të përshtatshme për përmbarim, pasi fatura janë në origjinal. Debitori i dytë si garantues në bazë të Deklaratës Garantuese është i obliguar të bëjë pagesa e faturave të cilat janë bashkëngjitura këtë urdhëri, ku janë të përshtatshme dhe i plotësojnë të gjitha kushtet ligjore në bazë të nenit 27, 29 dhe 38 të LPP-së. Në fund, ka theksuar se prapësimi i debitorit është bërë me qëllim të prolongimit të procedurës, ndërsa gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe urdhri për lejimin e përmbarimit të mbetet në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkaket si në vijim: Neni 29, paragrafi 1 i LPP-së, përcakton se: “Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”, ndërsa, pika 1.3 e njëjtit nen ka përcaktuar faturën si dokument të besueshme sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë, fillimisht ka vlerësuar faturat nr. 848/20, të datës 23.10.2020, në vlerë prej EUR 33,890.00 dhe faturën nr. 878/20, të datës 28.10.2020, në vlerë prej EUR 7,150.00, mbi bazën e së cilave është paraqitur propozimi për përmbarim dhe është lejuar urdhri, dhe gjeti se në kuptim të dispozitave të cituara më lartë, të njëjtat nuk paraqesin dokument të besueshëm në raport me debitorin KS “Prisig” Sh.a., ngase ky i fundit nuk është i evidentuar si debitor në fatura ngase të njëjtat janë në drejtim të debitorit “New

Group” L.L.C. Andaj, nisur nga fakti se në faturat në fjalë debitori i përmbartimit, nuk është emërtuar si debitor në dokumentet e besueshëm, prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 71, pikë a16. Kështu, Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar edhe Deklaratën Garantuese me numër 0700100114783, të datës 19.10.2020, mbi bazën e së cilës kreditori ka ushtruar propozimin për përmbartim ndërsa përmbartuesi ka lejuar urdhrin përmbartimor, mirëpo që të njëjtat deklarata nuk përmben dokument përmbartimor në kuptim të nenit 22 dhe 29 të LPP-së, rrjedhimisht nuk ka cilësinë e dokumentit të ekzekutueshëm apo të besueshëm mbi bazën e së cilit mund të kërkohet realizimi i kredisë në të holla. Andaj Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë gjen se sipas shkresave të lëndës, veç të metave të cekura si më lartë, gjykata gjen se urdhri mbi lejimin e përmbartimit është në kundërshtim edhe me nenin 39.1 të LPP-së, me të cilin parashihet se “Në qoftë se në bazë të dokumentit përmbartimorë dy apo më tepër debitor janë përgjegjës solidar, organi përmbartues, kundër tyre do të nxjerrë vetëm një aktvendim për përmbartimin, me të cilin bëhet sekuestrimi i llogarisë së debitorëve në shumatat e caktuara me anë të aktvendimit apo urdhrin për përmbartimin”, ngase në asnjërin nga dokumentet mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri nuk rezulton se debitori KS “Prisig” Sh.a, është solidarisht përgjegjës për përmbartjen e kredisë së kërkuar nga kreditori.

Dhoma e Shkallës së Dytë e vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se Gjykata e shkallës së parë, me rastin e vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar ka konstatuar drejt faktin se faturat nr. 848/20, të datës 23.10.2020, në vlerë prej EUR 33,890.00 dhe faturën nr. 878/20, të datës 28.10.2020, në vlerë prej EUR 7,150.00, mbi bazën e së cilave është paraqitur propozimi për përmbartim dhe është lejuar urdhri, nuk janë dokumente të besueshme sepse në këto fatura, debitori KS “Prisig” Sh.a., nuk është i evidentuar si debitor dhe të njëjtat janë në drejtim të debitorit “New Group” L.L.C, dhe për këtë fakt me që në fatura debitori i përmbartimit, nuk është emërtuar si debitor në dokumentet e

besueshëm andaj edhe nuk paraqetë dokument të besueshëm në raport me debitorin KS “Prisig” Sh.a.. Po ashtu edhe kjo gjykatë vlerësoj, se edhe Deklarata Garantuese me numër 0700100114783, të datës 19.10.2020, mbi bazën e së cilës kreditori ka ushtruar propozimin për përmbarrim, nuk përbën dokument përmbarrimor në kuptim të nenit 22 dhe 29 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë vlerësoj pretendimet ankimore të kreditorit lidhur me atë Kompania “Prisig” sh.a është palë që ka garantuar me polisën e sigurimit se në rast se debitori “New Group” L.L.C nuk përmbush detyrimin e saj, është Kompania “Prisig” sh.a ajo e cila e përmbush obligimin, por të njëjtat i refuzoj si të pa bazuar sepse siç u cek edhe më lartë deklarata garantuese nuk përbën dokument përmbarrimor në kuptim të nenit 22 dhe 29 të LPP-së, mirëpo kreditori mund të inicioj procedurë tjetër gjyqësore lidhur me realizimin e kërkesës së tij, varësisht nga suksesi në atë procedurë, po ashtu kjo gjykatë vlerësoj edhe pretendime tjera ankimore por të njëjtat nuk kishin ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje përmbarrimore.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Andaj, nga të cekurat kjo gjykatë vlerësoj se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë duhet vërtetuar dhe të refuzohet ankesa e kreditorit si e pathemeltë.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

### **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e shkallës së dytë**

K.DH.SH.II.nr.1508/23, me datë 17.04.2024

**Gjyqtarja,**

Franciska Zhitija Ymeri